



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1380 prot.
15

Tiranë më 10.10.2018

VENDIM

Nr. 51, datë 10.10.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1380 Prot., datë 13.09.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën e datës 20.07.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t' i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm në lidhje me:

1. *Sa është pagesa e bërë nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë për dëmshpërblime dhe shpenzime gjyqësore për shkak të humbjes së çështjeve gjyqësore nga UKT për vitet 2015, 2016 dhe 2017, e ndarë sipas viteve?*

Lidhur me sa kërkon në kërkesën e sipërcituar, ankuesi pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e Autoritetit Publik. Për këtë arsye, i është drejtuar me ankesë Komisionerit me qëllim ushtrimin nga ky i fundit të kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes me Urdhrin nr. 223, datë 19.09.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Res Publica” është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe i ka kaluar për trajtim Drejtorit të Drejtorisë Juridike. Koordinatori për të drejtën e informimit sqaroi grupin e inspektimit se kërkuessit i është kthyer përgjigje me shkresën nr. K-3221/1 Prot, date 06.08.2018, shkresë e cila është kthyer nga shërbimi postar me mbishkrimin ‘objekti i pakërkuar’.

Grupi i inspektimit konstatoi se në përgjigjen e sipërcituar, kërkuessit nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar me argumentin se: *Një kopje elektronike të pasqyrave financiare të Shoqërisë mund të gjenden të publikuara pranë QKB. Gjithashtu, lidhur me dëshmipërblimet e vendosura bazuar në vendimet gjyqësore, Autoriteti Publik i referohet Udhëzimit Nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përdorimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.*

Pas vlerësimit të argumenteve për refuzimin e dhënies së informacionit dhe pas kontaktit me përfaqësuesit e Autoritetit Publik, nga ana e grupit të inspektimit u kërkuar rivlerësimi i kërkesës për informacion brenda datës 21.09.2018.

Me shkresën nr. K-3221/2 Prot., datë 26.09.2018, Autoriteti Publik i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke sqaruar se, Qendrës “Res Publica” i është kthyer përgjigje me shkresën nr. K-3221/1 Prot., datë 06.08.2018. Autoriteti Publik konfirmoi në këtë mënyrë qëndrimin e mëparshëm, duke mos e rivlerësuar dhënien e informacionit pas inspektimit të ushtruar nga Zyra e Komisionerit.

Në vijim të inspektimit pranë Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, me shkresën nr. 1380/4 Prot., datë 01.10.2018, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore me datë 04.10.2018, ora 11:00, e cila nuk u zhvillua pasi palët e ftuara nuk u paraqitën.

Në lidhje me informacionin e kërkuar, Zyra e Komisionerit vlerëson se qëndrimi i Autoritetit Publik bie në kundërshtim me dispozitat dhe parimet e Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit. Sa i përket pasqyrave financiare, ato hartohen nga Autoriteti Publik dhe më pas depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit ku janë publike për këdo që ka interes t’i konsultojë nëpërmjet aplikimit dhe pagesës së tarifës përkatëse të zbatuar nga ky institucion. Qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik në rastin konkret bie në kundërshtim me pikën 3 të nenit 3 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Bazuar në këtë dispozitë Autoriteti Publik nuk mund të refuzojë vënien në dispozicion të ankuesit të informacionit të kërkuar duke qenë se ai është përpiluesi i këtij informacioni dhe e disponon atë në versionin origjinal.

Bazuar në pikën 2 të nenit 12, arsyeja e vetme që justifikon refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit dhe delegimin tek një institucion tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar.

Gjithashtu Zyra e Komisionerit gjen të pabazuar në ligj edhe argumentin lidhur me refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit që ka të bëjë me dëmshpërblimet dhe shpenzimet e paguara nga Autoriteti Publik si rrjedhojë e humbes së çështjeve gjyqësore. Duke qenë se fondet e përdorura për shlyerjen e këtyre shpenzimeve e dëmshpërblimeve janë publike dhe kërkesa është në përputhje me parimin e llogaridhënies së Autoriteteve Publike për përdorimin e fondeve publike, Zyra e Komisionerit vlerëson se informacioni përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” ndaj Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1380 Prot., datë 13.09.2018 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*Sa është pagesa e bërë nga Ujësjetllës Kanalizime Tiranë për dëmshpërblime dhe shpenzime gjyqësore për shkak të humbjes së çështjeve gjyqësore nga UKT për vitet 2015, 2016 dhe 2017, e ndarë sipas viteve*), brenda datës 17.10.2018.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.10.2018.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

